



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1039/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Zeliha Kutllovci - Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Vushtrri, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1039, Anr.1040, Anr.1041, Anr.1042, Anr.1043, Anr.1044 Anr.1045, Anr.1046, Anr.1047, Anr.1048, Anr.1049, Anr.1050, Anr.1051, të datës 03.12.2013, të Zeliha Kutllovcit Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Vushtrri.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1039, Anr.1040, Anr.1041, Anr.1042, Anr.1043, Anr.1044 Anr.1045, Anr.1046, Anr.1047, Anr.1048, Anr.1049, Anr.1050, Anr.1051, të datës 03.12.2013, nga Zeliha Kutllovci - Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Vushtrri, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur manipulime me vota, pa rregullsi si dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit nëpër QV në Vushtrri.

- Në ankesën Anr.1039/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në shkollën fillore “Ali Kelmendi “ e njëjta Qendër e Votimit QV 2702B kanë votuar personat me mbiemër me iniciale “P”. Më tutja ka thkesuar se, duke qenë se jamë shumë i sigurt në votat e familjarëve, kolegëve dhe miqëve të mijë, të gjitha këto veprime i konsideroj si shkelje të LZP, pasi që në mënyrë direkte jamë i dëmtuar në cilësinë e kandidatit për Asamble Komunale. .
- Në ankesën Anr.1040/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në KKZ dhe në QV 2706B kanë ndodhur keqpërdorime të mëdha, pasi që ka munguar FPR nga e njëjta QV, ku personat me me njohuri dhe përvojë kanë arritur që ti mbajnë në heshtje të gjitha pa rregullsit e bëra.
- Në ankesën Anr.1041/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2702X pra në të gjitha vendvotimet VV, dyshoj se janë orkestruar votat , ku e drejta ime për

tu zgjedhur është mohuar, pasi që individ të ndryshëm dhe me ndikim kanë operuar në këtë QV.

- Në ankesën Anr.1042/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2701B pra në të gjitha vendvotimet VV nga i njëjti sistem i punës janë keqpërdorur votat e familjarëve, miqëve dhe kolegëve që mu janë dhënë mua. Më tutja ka theksuar se, dallimi qëndron në të dhënat e KVV-së KKZ-së dhe KQZ-së që vërtetojnë keqpërdorimin e votave. .
- Në ankesën Anr.1043/13 të datës 03. 12.2013, pretendohet se në QV2727B ka mospërputhje të rezultateve në tëri nivelet e KVV-së KKZ-së dhe KQZ-së, pasi që sipas RPR orientimi i votës ka qenë i centralizuar ashtu sikurse te subjekti politik që i takoj në radhët e AAK-së.
- Në ankesën Anr.1044/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2709B pra në të gjitha Vendvotimet VV ka pasur pa rregullsi të shumta gjatë procesit të votimit dhe numërimit, ku anëtari i KVV-së – bashkëshorti i një kandidate ka qenë në mbajtje nga policia . Më tutja ka theksuar se, kandidatja tjetër me inicialet A.I. ka pasur familjar në të njëjten QV, ku personat në fjalë janë të njohur për manipulime. .
- Në ankesën Anr.1045/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2704B janë bërë manipulime të mëdha, pasi që në këtë zonë kanë operuar kandidatë të cilët edhe më parë kanë qenë të njohur keqpërdorime. Më tutja ka theksuar se, dallimi në mes të rezultateve të KKZ-së dhe KQZ-së është shumë i madhë, sepse në të njëjtën QV ka votuar familja ime dhe gjysma e tyre nuk figurojnë në rezultatet përfundimtare.
- Në ankesën Anr. 1046/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2711B pra në të gjitha Vendvotimet VV ka pasur mospërputhje të rezultateve në mes të KQZ-së dhe KKZ-së. Më tutja ka theksuar se, në të njëjtën QV shumica e anëtarëve të KVV-së kanë qenë familjarë dhe persona që në mënyrë jo ligjore kanë përfaqësuar interesat e individëve të caktuar.
- Në ankesën Anr.1047/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2708B kanë ndodhur keqpërdorime në mes anëtarëve të KVV-së, pasi që në të njëjtën QV janë keqpërdorur mbi 20 vota, pasi që në të gjitha VV ka pasur keqpërdorime brenda secilës parti politike në favor të disa kandidatëve të caktuar.
- Në ankesën Anr.1048/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në fsh. Stanovc i Epërm, në QV 2710B përherë ka keqpërdorime gjë që ka ndodhur edhe kësaj radhe.Nga e njëjta QV janë manipuluar rezultatet në KKZ. Më tutja ka theksuar se, raporti i vëzhguesve është vonuar për më tepër se dy orë nga të QV.
- Në ankesën Anr.1049/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se Në qv 2712B si dhe në të gjitha vendvotimet mungojnë votat e rrethit timë familjar. Më tutja ka theksuar se, kjo është një zonë ku ka pasur shumë kandidatë të cilët kanë pasur familjar dhe njerëz të afërm në cilësi të anëtarëve të KVV-së, të njëjtit sipas

interesave kanë orkestruar shpërndarjen e brendshme të votave duke i vjedhur votat e mia

- Në ankesën Anr.1050/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2713B pra në të gjitha Vendvotimet VV ka pasur familjar të kandidatëve për Asamble Komunale, në cilësi të anëtarëve të KVV-së. Më tutja ka theksuar se, numëri total i votave është shpërndarë për kandidatë nëpër secilin VV, pasi që në mënyrë të organizuar dhe me marrëveshje vota e lirë është keqpërdorur.
- Në ankesën Anr.1051/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2714B mungojnë më tepër se 20 vota, pasi që në të njëjtën QV ashtu sikurse në të gjitha të tjerat ka ndodhur orkestrimi i shpërndarjes së votës, ku anëtarët e KVV-së kanë operuar në mënyrë favorizuese për individë të caktuar.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”*. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Zeliha Kutllovcit - Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Vushtrri, paraqitur kundër Komisionerëve në Këshillat e Vendvotimit KVV dega në Vushtrri, ku të njëjtit kanë bërë pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit nëpër VV në Vushtrri, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në VV, e lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 1039/2013 më datën 06.12.2013



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.